



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 266/3 Prot

Tiranë, më 21 /03/2017

VENDIM

Nr. 54, datë 21/3 /2017

Në mbështetje të nenit 21, pika 1/b, 3 dhe 4 të ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri")

VËREN:

Ankuesi, Shoqata "Intelektualët e Rinj, Shpresë" (në vijim quajtur I.R.SH.) ka depozituar pranë zyrës së Komisionerit ankesën Nr. 266 Prot., datë 10.02.2017, ndaj Organit Publik/Bashkia Shkodër (në vijim quajtur "Organi Publik") me objekt "Ankim lidhur me cënimin e së drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik për buxhetin e vitit 2017 dhe planin buxhetor afat-mesëm 2018-2019 të Bashkisë Shkodër".

Rezulton se ankesa është depozituar në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 21, pika 1/b të Ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" (në vijim quajtur "Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"), për shkak se projektakti është njoftuar i miratuar dhe si i tillë ankuesi legjitimohet në paraqitjen e saj në afat.

Gjithashtu, ankuesi legjitimohet në ngritjen e objektit të kësaj ankese në përputhje me pikën 1/b të nenit 8 të ligjit 146/2014, në të cilën thuhet shprehimisht se, "...palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik janë shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit...". I.R.SH. në zbatim të objektit të veprimtarisë së saj, konsiderohet grup interesi në lidhje me konsultimin e buxhetit të vitit 2017 dhe planin buxhetor afat-mesëm 2018-2019 dhe për rrjedhojë ka të drejtë të marrë pjesë në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

Pas vlerësimit të ankesës së I.R.SH. në përputhje me pikën 3 të nenit 21 të ligjit nr. 146/2014 në të cilit citohet se "...me marrjen e një ankese, Komisioneri i kërkon ankuesit dhe organit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrimet me shkrim brenda 10 ditëve", Komisioneri me shkresën Nr. 266/1 Prot., datë 14.02.2017 ka kërkuar nga Organi Publik të paraqesë parashtrime me shkrim brenda këtij afati.

Organi Publik, në parashtrimet e depozituara me shkresën Nr. 2844 Prot., datë 01.03.2017, lidhur me ndjekjen e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik parashikuar në Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, parashtron se:

- Mbledhja e datës 24.01.2017 është thirrur nga Këshilli i Bashkisë Shkodër, i cili ka zhvilluar seancë të hapur konsultimi publik për projekt-buxhetin 2017 të Bashkisë Shkodër. Ky takim është zhvilluar në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku përcaktohet: Këshilli Bashkiak ose Këshilli i Qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”... dhe pas miratimit nga ana e kryesisë së këshillit. Ky takim këshillimi me publikun i organizuar nga këshilli bashkiak, është njoftuar në faqen zyrtare të bashkisë, në faqen facebook të bashkisë, në mediat lokale dhe stendën e informimit në ambientet e bashkisë. Sqarohet gjithashtu (vijon parashtrimi), siç edhe është bërë publike, se projekt buxheti 2017 është miratuar në mbledhjen e këshillit bashkiak në datën 30 Janar 2017.
- Subjekti ankimues ka qenë i pranishëm në dëgjuesën publike të organizuar nga këshilli i bashkisë, por nuk ka shfaqur ankesë për procedurën e ndjekur.
- Nuk rezultoi të ketë ankesa nga qytetarë apo organizata të shoqërisë civile.
- Bashkia Shkodër gjatë vitit 2016 ka zhvilluar dëgjesa me publikun, në të cilat subjekti ankimues në një pjesë të rasteve ka qenë i pranishëm.
- Subjektit ankimues i janë dërguar pas një kërkesë të bërë nga ana e tyre, raporte të dëgjësave me publikun të bëra për periudhën Janar 2016-Janar 2017, raporte të cilat do jua dërgojmë dhe juve me anë të postës elektronike.
- Bashkia Shkodër, siç nuk ka ndodhur kurrë më parë, gjatë proceseve të konsultimit dhe dëgjësave me publikun, është treguar transparente duke marrë të gjitha masat e nevojshme për një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të publikut dhe të grupeve të interesuara. Bashkia Shkodër ka marrë në shqyrtim sugjerimet e marra nga grupet e interesit, të cilat i kemi pasqyruar dhe në planin buxhetor 2017 dhe atë afat-mesëm 2018-2019.

Në arsyetim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri konstaton se shpjegimet në parashtrime bien ndesh me kërkesat e Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Konsultimi publik është një proces që duhet zbatuar në kuadër të transparencës, njohjes, konsultimit dhe edukimit ligjor nga të interesuarit, kategori e përcaktuar në këtë ligj.

Në rastin konkret shpallja për konsultimin publik për Buxhetin e vitit 2017 dhe planin buxhetor afatmesëm 2018-2019 të Bashkisë Shkodër, për datën 24.01.2017, është bërë në datë 21.01.2017, ndërsa projekt buxheti 2017 është miratuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me datë 30 Janar 2017 (sipas faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër/depozituar e printuar nga ankuesi).

Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, në nenin 17 pika 2 parashikon afatet taksative të njoftimit për palët e interesuara të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike duke u dhënë kohën e nevojshme për përgatitje dhe vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet.

Konkretisht në këtë dispozitë parashikohet:

“Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet”.

Ndjekja e procesit të bashkërendimit dhe administrimit të përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik, duhet/j bërë nga koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik i cili në kuptim të nenit 10 të ligjit të sipërcituar është përgjegjës për këtë proces.

Pas konsultimit të ligjit në tërësi, dispozitës së mësipërme në veçanti, por edhe referuar parashtrimeve të Organit Publik në të cilat nuk provohet ndjekja dhe zbatimi i kërkesave dhe procedurave të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, arrihet në përfundimin se Organi Publik ka vepruar në kundërshtim me këtë ligj lidhur me rastin objekt ankimi.

Në përfundim, konstatohet se procesi i konsultimit të projektbuxhetit nga Organi Publik është bërë në kundërshtim me çfarë parashikon Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Për të gjithë konstatimet e përmendura më sipër, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 4 të nenit 21 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës Nr.266 Prot., datë 10.02.2017 të Shoqatës “Intelektualët e Rinj, Shpresë” kundër Organit Publik/Bashkisë Shkodër me objekt “Ankim lidhur me cënimin e së drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik për buxhetin e vitit 2017 dhe planin buxhetor afat-mesëm 2018-2019”.
2. T’i propozoj Organit Publik/Bashkisë Shkodër, marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës (në kuptim të nenit 10 të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik), sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u shpall sot me datë 21.3.2017.

